



RAPORT MONITORIMI “LUFTA NDAJ KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”



Tiranë, Korrik 2023



Ky raport është pjesë e projektit “FOL PËR DREJTËSINË”, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës “FOL” dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Përgatiti: Z.Isuf Shehu, Ekspert Ligjor i Jashtëm

Kontribuan në hartimin e raportit:

1. Z.Bledar Zaganjori, Gazetar, Ekspert i Jashtëm,
2. Znj.Bleona Metushi, Gazetare, Eksperte e Jashtme,
3. Znj.Esmeralda Keta, Gazetare, Eksperte e Jashtme,

Rishikoi: Znj. Anila Hoxhaj, Gazetare, Drejtore Ekzekutive, Qendra “FOL”

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Qendra “FOL”

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Qendra “FOL” në adresën e mëposhtme:

Adresa: Rruga “Pjetër Budi” , godina numër 69, Tiranë

E-mail: gendrafol@gmail.com

Telefon: +355682082888

Përmbajtja e Punimit	Faqe
Hyrje	4-5
Përmbledhje Ekzekutive	6-9
KREU I	
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT	
1. Trendi i ndërmarrjes së akteve korruptive në kohë.....	10
1.1. Përfaqësuesit e autoriteteve publike dhe subjektet fizike të përfshirë në akte korruptive..	10
1.2. Statusi procedural i shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kategorinë “Korrupsion”.....	10-12
KREU II	
2.1. Shpërdorimi i detyrës, neni 248 i Kodit Penal.....	13
2.2. Vepra penale e “Korrupsionit aktiv i funksionarëve” dhe e “Ndikimit të paligjshëm”..	13-14
2.3. Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike.....	14
2.4. Pastrimi i parave, refuzim /deklarim pasurie	14-16
2.5. Krimet Zgjedhore.....	16-21
KREU III	
LUFTA KUNDËR DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR	
3.1. Lufta kundër trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar.....	21-23
3.2. Trafikimi i lëndëve narkotike sipas nenit 283/a Kodit Penal.....	24-24
3.3. Kultivimi i bimëve narkotike sipas nenit 284 i Kodit Penal.	24-25
3.4. Vepra penale “Grupi i Strukturuar Kriminal” parashikuar në nenin 333/a të Kodit Penal.....	25-26
3.5. Vepra penale e “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal	26-28
KREU IV	
4.1 Të dhëna nga projekti i parë “FOL Për Drejtësinë”.....	28-35
KREU V	
5.1 Problematika të hasura gjatë punës hulumtuese 12-të mujore.....	35-35
5.2 Rekomandime	36-36

HYRJE

Qendra “FOL” nëpërmjet ekspertëve të saj ka monitoruar për një periudhë nga data 01.08.2022-10.07.2023, ecurinë e procedimeve penale të bëra publike pranë Stukturës së Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) si dhe çështjet e papërfunduara nga projekti i mëparshëm¹ “FOL Për Drejtësinë”, (periudha 01.11.2020-31.10.2021). Gjatë projektit të dytë “FOL Për Drejtësinë”, Qendra “FOL” ka publikuar raporte periodike 3 mujore², 6 mujore³ dhe 9 mujore⁴.

Veprimtaria e ekspertëve është mbështetur në një metodologji të specifikuar monitorimi nga të dhënat e pasqyrura në databazën <https://webapp.fol.org.al/publik.php>, për kategorinë e veprave penale që janë pjesë e Kreut VIII, seksioni I, i Kodit Penal i cili parashikon figurat e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit (neni 244, 244/a, 245, 245/1), Seksioni II, “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”, i cili parashikon nenin 257, 258 paragrafi 2, figurat e veprave penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259); korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë (neni 259/a); korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë (neni 260);Kreu IX, “Vepra penale kundër drejtësisë”, në të cilin parashikohen figurat e veprave penale të korrupsionit aktiv të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit (neni 312), korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë (neni 319), korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare (neni 319/a), korrupsioni aktiv i arbitrit vendas edhe të huaj (neni 319/b), korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja (neni 319/c), korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë (neni 319/ç), korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare (neni 319/d), korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj (neni 319/dh), korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja (neni 319/e), përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike apo zgjedhore (Neni 328/a), refuzim për deklaram apo fshehje pasurie (Neni 257/a/2/); Kreu XI i Kodit Penal, në të cilën parashikohen veprat penale si organizatat kriminale (Neni 333), grup i strukturuar kriminal (Neni 333/a), kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal (Neni 334).

Grumbullimi i të dhënave rreth këtyre kategorive të veprave penale u bë i mundur në kuadër të hulumtimit të praktikave hetimore dhe gjyqësore, duke përfshirë fazën e hetimeve paraprake deri në gjykimin pranë Gjykatës së Posacme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

¹ <https://webapp.fol.org.al/publik.php>

² <https://fol.org.al/korrupsioni-nen-monitorim-raporti-3-mujor/>

³ <https://fol.org.al/raporti-6-mujor-i-qendres-fol/>

⁴ <https://fol.org.al/raport-9-mujor-mbi-dosjet-publike-ne-spak/>

Organizuar(GJKKO) , Gjykatën e Posacme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatën e Lartë.

Me qëllim reflektimin objektiv të të dhënave të grumbulluara, databaza e ngritur nga ana e Qendrës “FOL” ka shërbyer si një arkivë e mirëfilltë dhe e strukturuar informacioni, e cila jemi të bindur se do të shërbejë pozitivisht dhe do të lehtësojë punën e mëtejshme të studiuesve të së drejtës, ekspertëve të fushës, medias dhe të interesuarve për të hulumtuar mbi këto kategori të veprave penale. Në këtë databazë të aksesueshme online nga ana e publikut, ekspertët kanë reflektuar çdo rast që përbën vepër penale dhe është në kompetencë të SPAK, ecurinë e procedimeve publike, si dhe të gjithë procesin e procedimit të organit të akuzës si, regjistrimi i veprës penale, caktimi i masës së sigurimit, dërgimi i çështjes për gjykim.

Qendra “FOL” dëshiron të falenderojë Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, institucionet kyçe që luajtën një rol të rëndësishëm në implementimin e projektit “Fol për Drejtësinë” si përfaqësuesit e sistemit gjyqësor, që ushtrojnë funksionin pranë Gjykatave penale të të gjitha shkallëve të gjyqimit në Tiranë, si dhe ekspertët e angazhuar në terren në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave.


Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë monitorimit 1 vjeçar të realizuar, ekspertët e Qendrës “FOL” kanë arritur të identifikojnë disa gjetje kyçe, të cilat reflektohen në këtë seksion të përmbledhjes ekzekutive në versionin e konkluzioneve paraprake.

➤ **Kategoria e veprave penale në fushën e korrupsionit:**

1. Janë monitoruar në total 100 procedime penale të regjistruar gjatë periudhës 1 gusht 2022 deri më 10 korrik 2023 të përfshira në kategorinë e veprave penale në fushën e korrupsionit, të cilat përbëjnë rreth 51% e totalit të procedimeve të monitoruara. Më konkretisht, 29 raste ose rreth 15% të regjistruara në vitin 2022, ndërkohë 71 raste ose rreth 36% janë regjistruar në vitin 2023 deri në datën 10 Korrik.

2. Sa i përket të dhënave statistikore të monitoruara gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2022 rezulton se muaji nëntor (14 raste) mban vendin e parë sa i përket periudhës kohore gjatë së cilës është regjistruar numri më i lartë i procedimeve në fushën e korrupsionit, ndjekur më pas nga muaji dhjetor (6 raste) dhe muaji shtatori (5 raste). Periudha tjetër që i përket gjashtë mujorit të parë të vitit 2023 konstatohet një aktivitet më dinamik nga ana e SPAK, ku muaj maj kulmon (18 raste) i cili pasohet nga muaji qershor (17 raste). Ky ndryshim është rezultat edhe i zgjedhjeve për pushtetin vendor, të mbajtuara në 14 Maj 2023.



3. Nga 100 raste të korrupsionit të regjistruara pranë organeve proceduese, rezulton se numrin më të lartë të subjekteve të përfshira e mbajnë zyrtarët dhe ish-zyrtarët e lartë (si psh kryetarët e bashkive). Konstatohen kallëzime të paraqitura dhe procedime penale të nisura në total 29 raste, ndërsa kallëzimet publike nga qytetarët janë në total afërsisht 15% të të gjitha rasteve.

4. Duke pasur parasysh që rastet objekt monitorimi kryesisht janë ato të ndjekura nga SPAK, konstatohet në të shumtin e rasteve hetimet paraprake po zhvillohen në kushtet e masave të sigurimit personal “arrest në burg”, konkretisht në 49 raste ose rreth 49% të rasteve korruptive, pavarësisht ekzekutimit të tyre.

5. Shpërdorimi i detyrës i cili përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, në përputhje me parashikimin e nenit 248 K.P. është monitoruar nga ana e ekspertëve në 32 raste ose rreth 16.4% të të gjitha rasteve të monitoruara nga ekspertët e Qendrës FOL ose 32% të rasteve korruptive, duke krijuar përshtypjen se kjo veprë penale tashmë përbën një ndër degëzimet kryesore në kategorinë e veprave penale në fushën e korrupsionit. Kjo veprë penale hetohet nga Prokuroria e Posaçme vetëm kur kryhet nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur (neni 75/a gërma b e Kodit të Procedurës Penale), ose nga subjekte të posaçme sipas parashikimeve të nenit 75/a gërmat c dhe ç të Kodit të Procedurës Penale).

6. Në rastet kur personat përveç veprave penale të tjera janë proceduar edhe për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” rezulton se në 8 raste ose rreth 18% , përfaqësuesit e organit të akuzës të kenë kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, ndërkohë konstatohet se kërkesa e prokurorit për caktimin e kësaj mase të jetë aprovuar në të gjitha rastet nga ana e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Por kjo masë siguri personal është ruajtur deri në Gjykatën e Apelit vetëm për 5 raste, pasi 1 rast nuk është ankimuar.

7. Procedimet penale të iniciuara kryesisht nga organet e ndjekjes penale dhe posaçërisht nga SPAK zënë pjesën më të madhe të procedimeve penale të regjistruara dhe të atyre për të cilat është paraqitur kërkesa për gjykim. Konstatohet që për periudhën 12 mujore të monitorimit, nuk rezulton që për kallëzime të paraqitura nga individë, grupime individësh, parti politike, avokatë, të jenë thirrur në cilësinë e personave që i atribuohet vepra penale, personi ndaj të cilit po zhvillohen hetimet.

-Një rast i monitoruar nga ekspertët e Qendrës “FOL” me palë të kallëzuar shtetasin me initiale I.M. , rezulton se SPAK shpalli moskompetencën duke e përcjellë çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Rezulton se shtetasi me initiale I. M. nuk është marrë në pyetje nga prokurori i çështjes mbi rrethanat e kallëzimit.

-Në një rast tjetër të monitoruar nga Qendra FOL, është konstatuar se, në SPAK dy qytetarët M.H dhe Z.H, përmes një prokure të lëshuar avokatit të tyre kallëzuan ish presidentin S.B⁵ dhe 14 persona të tjerë për veprën penale “ vrasje me paramendim” parashikuar nga neni 78/2 i K.P, “krijim i bandës së armatosur dhe organizatës kriminale”, parashikuar nga neni 333 i K.P,

⁵ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2334>

“akte terroriste”, parashikuar nga neni 230 i Kodit Penal. Në këtë rast SPAK pyeti palën denoncuese, por ende nuk janë marrë dëshmitë e palës tjetër.

8. 12 raste janë regjistruar nga Prokuroria e Posacme për veprën penale të “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Në 7 raste, Prokuroria e Posacme ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “arrest ne burg”, ndërsa Gjykata e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka konfirmuar masën e sigurimit “arrest në burg” në 6 raste.

Për këtë veprë penale, pas paraqitjes së kërkesës për gjykim në 2 raste nga ana e të pandehurve është kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar.

Në 1 rast, gjykata e ka zbutur masën e sigurisë duke vendosur atë të “arrestit në shtëpi” ndryshe nga masa e “arrestit në burg”, e kërkuar nga Prokuroria e Posacme.

9. Punonjës policie kanë rezultuar të përfshirë në vepra penale në fushën e Korrupsionit, konkretisht nga SPAK janë regjistruar 13 raste, për të cilat organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

➤ **Kategoria e veprave penale në fushën e drogës dhe krimit të organizuar:**

1. 95 raste ose rreth 49% e numrit total të materialeve, janë monitoruar nën kategorinë e veprave penale në fushën e Drogës dhe Krimit të Organizuar. 30 raste ose rreth 32% e materialeve janë adresuar pranë organeve proceduese për veprën penale ‘trafikim i narkotikëve’, parashikuar nga neni 283/a i K.P, duke bërë që kjo të jetë dispozita më e përdorur. Konstatohet se muaji Qershor 2023 (19 raste) dhe Nëntor 2022 (9 raste) janë muajtë në të cilat janë ndërmarrë operacionet më të rëndësishme në fushën e luftës kundër lëndëve narkotike.

2. Në 13 raste ose rreth 14.% ekspertët kanë monitoruar materiale të referuara për “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike në formën klasike”, parashikuar nga neni 283 i K.P. Në 11 raste prokuroria ka kërkuar masën e sigurisë “arrest ne burg”. Gjykata e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur masën e sigurisë “arrest në burg” në 11 raste ose rreth 87 % të rasteve. Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë dhe në 3 raste mospranim ankimi, pasi nuk është dorëzuar në zbatim të parashikimeve ligjore.

3. Ashtu si në monitorimin e projektit të parë “FOL Për Drejtësinë”u konstatuan oficerë policie për veprat penale në fushën e drogës,. Edhe në këtë monitorim, konstatohet se 1 punonjës policie ka rezultuar i përfshirë në veprën penale në fushën e narkotikëve, në bashkëpunim me shtetas të tjerë të njohur për uniformat blu, si përdorues dhe shitës të lëndës narkotike.

4. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” nuk është kërkuar nga ana e Prokurorisë në asnjë rast, dhe gjithashtu nuk është parë e arsyeshme as nga Gjykata e Posacme vendosja e kësaj mase në rastet e referuara nga prokuroria.

5. Sa i përket veprës penale të “trafikimit të lëndëve narkotike” parashikuar në nenin 283/a të Kodit Penal u konstatua se nga 30 raste organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, për 29 raste kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në 27 raste.

6. Për kultivimin e bimëve narkotike janë depozituar 13 materiale, ndaj 6 prej tyre është kërkuar caktimi i masës “arrest në burg”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në 4 raste, duke ndryshuar në 2 raste masën e sigurimit “arrest në burg” duke e zbutur në atë të “arrestit në shtëpi”. Vendimi i Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimit të Organizuar është lënë në fuqi nga Apeli vetëm për 4 raste. Në 2 raste, Gjykata e Apelit ka ndryshuar masën e sigurimit “arrest në shtëpi” në atë të “arrestit në burg”. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” rezulton të mos jetë kërkuar nga ana e organit të akuzës në asnjë rast. Prokuroria e Posacme në 1 raste ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Kryesisht shtetasit e përfshirë në këto raste rezultojnë të bashkë-pandehur, ndërkohë që roli i tyre në realizimin e veprës penale nuk ka rezultuar nga hetimi që të ketë qenë i një niveli të tillë sa të aplikohen masa sigurimi më të rënda.

7. Nga monitorimi i 38 rasteve të kategorizuara si krim i organizuar, ekspertët konstatojnë se masa e sigurimit “arrest në burg” e caktuar ndaj disa prej tyre (2 raste), në rolin e krerëve nuk ka mundur të ekzekutohet për shkak se ata vijnë në kërkim.

8. Për rastet e kategorizuara si ‘Krim i Organizuar’ janë depozituar 38 materiale, ndaj 31 prej tyre ose rreth 81% është kërkuar caktimi i masës “arrest në burg”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në 30 raste, duke ndryshuar në 1 rast masën e sigurimit “arrest në burg” duke e zbutur në atë të “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

KREU I

VEPRAT PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT

1. Trendi i ndërmarrjes së akteve korruptive në kohë

Raporti i Freedom House lidhur me korrupsionin dhe pavarësinë e gjyqësorit referon se “*Falë aktivitetit të SPAK-ut, lufta kundër korrupsionit ishte i vetmi drejtim ku Shqipëria shënoi përmirësim të lehtë*”. Në raport përmendet dënimi i ish-ministrit të brendshëm me iniciale S. T., me tre vjet e gjysmë burg, për veprën penale shpërdorim detyre, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal .

Sipas Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit te vitit 2023, mangësitë me pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit, mungesa e mediave të pavarura dhe korrupsioni i vazhdueshëm në qeverisje, në organet e zbatimit të ligjit dhe në institucionet lokale, ishin problemet kryesore në Shqipëri gjatë vitit të kaluar.

Ndër të tjera në raport citohet “*Ndonëse Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur, “presioni” politik, frikësimi, korrupsioni dhe burimet e kufizuara e penguan gjyqësorin të funksiononte plotësisht, në mënyrë të pavarur dhe efikase*”.

1.1. Përfaqësuesit e autoriteteve publike dhe subjektet fizike të përfshirë në akte korruptive

Përfaqësues të institucioneve publike si funksionarë të Njësive të Qeverisjes Vendore, Deputetë, Kryetarë dhe ish-Kryetarë Bashkie, Anëtarë të Njësive së Prokurimit Publik, ish drejtues dhe drejtues të Drejtorive rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, punonjësit e institucioneve të ndryshme të sistemit penitenciar (burgjeve) ose atyre të Policisë së Shtetit etj., si dhe përfaqësues të subjekteve private si kompani ndërtimi, rezultojnë të kallëzuar nga ana e shtetasve të ndryshëm fizikë dhe të proceduar kryesisht si autorë të dyshuar të veprave penale në fushën e korrupsionit.

-Theksojmë se janë 3 kryetarë bashkish, ai i Tiranës, Vorës dhe Kuçovës që janë kallëzuar për veprat penale të “shpërdorimit të detyrës” parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal, “falsifikimin e vulave, stampave dhe formularëve” parashikuar në nenin 190 të Kodit Penal dhe për veprën penale të “korrupsionit të funksionarëve të lartë shtetëror dhe të zgjedhurve vendor” parashikuar në nenin 245 të Kodit Penal.

Përvec kësaj, nga ana e SPAK po zhvillohen hetimet nën masën e sigurimit “arrest në burg” ndaj tre kryebashkiakëve dhe 2 ish-kryebashkiakve, (të Himarës, Durrësit, Bulqizës, Kukësit, Fushë Arrëz⁶) të cilët po hetohen për akuzat “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K.P , “shkelje e barazisë në tendera apo ankande publike” parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, “korrupsion aktiv në zgjedhje të kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 328 e 25 i Kodit Penal.

⁶ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-13-07-2023/>

-Monitorimi i Qendrës FOL , tregon se në një rast SPAK ka kërkuar që ti vihen në dispozicion edhe regjistrimet audio-video të shfaqura nga një emision investigativ, në lidhje me veprimet korruptive të kryetares aktuale të Bashkisë së Roskovecit, e cila ka nxitur dhe shantazhuar individë të caktuar për të dhënë votën e tyre për të, gjatë zgjedhjeve të 14 Majit 2023.

-Aktualisht ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posacme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vetëm për kryebashkiakun e Mallakastrës, i cili është dënuar me 40 orë punë publike, vendim që është ankimuar nga ky i fundit. Në përmbledhje të gjithë kësaj, konstatojmë se nga 61 Bashki në Republikën e Shqipërisë aktualisht në hetim dhe gjykim janë veprimtaritë e 9 Bashkive të cilat përbëjnë 15% të numrit total të Bashkive në Republikë.

➤ **Nëpunësit publikë**

Për dy bashki atë të Bulqizës dhe Durrësit , hetimet për veprimtari korruptive nuk janë vetëm ndaj Kryetarëve dhe ish-Kryetarëve por edhe ndaj nëpunësve publikë dhe personave privatë jashtë administratës vendore.

-Gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2022, SPAK ka kërkuar arrestimin e 11 personave të implikuar në skemën e “mashtimit” në Inceneratorin e Fierit. Administratorët e Shoqërive të kontraktuara nga shtetasi me iniciale K.Z. si dhe supervisorët e punimeve në incenerator janë përfshirë në një veprimtari mashtrimi duke lëshuar fatura fiktive punimesh dhe shërbimesh si dhe duke pranuar situacionimin e punëve të pakryera me qëllim përfitimin e fondeve dhe pagesave nga buxheti i shtetit. Përveç tyre, SPAK i ka komunikuar akuzën ish sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, për korrupsion dhe pastrim parash për inceneratorin e Elbasanit. Ndaj shtetasit A. B., prokuroria ka kërkuar dënimin me shtatë vjet burg për veprimtari korruptive në inceneratorin e Fierit dhe 4 vite burgim për inceneratorin e Elbasanit. Hetimet ndaj këtyre personave, përveç rastit të shtetasit A.B., pavarisht se mund të mos jenë prezentë elementët e “veprës penale të kryer në bashkëpunim” janë pjesë e një fashikulli hetimi dhe po hetohen të bashkuar për shkak se procedimet janë të lidhura.


1.2. Statusi procedural i shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kategorinë “Korrupsion”.

Konstatohet se referimi i shtetasve në “arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi” është statusi procedural më i përdorur, konkretisht në 49 raste në 100 raste objekt monitorimi të periudhës 1 gusht 2022 - 10 Korrik 2023. Të dhëna statistikore të kësaj natyre nxisin në analizimin e disa faktorëve ndikues siç është prezenca e krijuar nga hetimet dhe gjykimet e funksionarëve të lartë publikë, sic është rasti i ish-Prokurorit të Përgjithshëm me iniciale A. LL, i akuzuar dhe dënuar për veprën penale të “Mosdeklarimit të të ardhurave...” parashikuar në nenin 257/a të Kodit Penal për të cilën legjislatori kishte parashikuar një dënim deri në tre vjet. Por përveç kësaj, nga ana e SPAK synohet implementimi i një politike të ashpër penale në lidhje me zbatimin e masave të sigurimit duke synuar dekurajimin e funksionarëve publikë në sipërmarrjen e akteve korruptive, shpërdorimin e detyrës dhe abuzimit me pasurinë publike dhe përfitimin në mënyrë të padrejtë të pasurisë publike dhe private. Në shumicën e rasteve, caktimi i masave të sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” janë marrë nga Gjykata kompetente në kushtet e mungesës së personit të interesuar. Në këtë mënyrë atij mund t’i garantohet e drejta për tu

dëgjuar për masën e dhënë vetëm pas ndalimit dhe komunikimit të vendimit brenda afateve procedurale. Nga monitorimi i Qendrës “FOL” ka rezultuar se SPAK është shprehur para Gjykatës së Posacme, se personat për të cilët është kërkuar një masë sigurimi “arrest në burg” është bërë për shkak të vlerësimit të rrezikshmërisë të veprës penale dhe dyshimeve se personat nën hetim mund të prishin provat.

Gjykatat në secilin rast kanë marrë parasysh pretendimin e paraqitur nga prokurori mbi rrezikun e shkatërrimit të provave dhe mundësisë që personi ti shmanget drejtësisë.

Kjo nënkupton që masat e sigurimit në asnjë rast nuk kanë qenë një kundërpërgjigje e ndonjë prej kallëzimeve të dorëzuara nga individë, profesionistë të ligjit apo grupime politike.



Nga monitorimi konstatohet se nga data e depozitimit të kallëzimit publik (nga subjekte të ndryshme), ecuria e hetimeve është më e ngadaltë sesa hetimet e celura kryesisht nga SPAK,


me përjashtim të denoncimeve të subjektit "Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit", ku vendimmarja për mosfillimet nga ana e SPAK është kryer brenda një kohe të shkurtër.

KREU II

2.1 Shpërdorimi i detyrës, neni 248 i Kodit Penal

Pavarësisht faktit që kjo vepër penale nuk është pjesë e kompetencës lëndore të veprimtarisë së SPAK, por e Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton se shpërdorimi i detyrës është ndër akuzat më të shpeshta të bëra ndaj funksionarëve të lartë dhe të zgjedhurve. Kjo vepër penale i është atribuar subjekteve në 27 raste.

Në pjesën më të madhe të rasteve, procedimi penal është regjistruar nga SPAK, 12 raste ose rreth 44% të rasteve me këtë akuzë, në rastet e tjera është regjistruar në bazë të kallëzimeve nga subjekte të tjera, konkretisht 8 raste të kallëzuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, 4 raste nga Partia Demokratike, 2 raste nga individë dhe 1 rast nga Kandidat i Koalicionit "Bashkë Fitojmë".



2.2. Vepra penale e "Korrupsionit aktiv i funksionarëve" dhe ajo e "Ndikimit të paligjshëm"

Për veprat penale të parashikuara në nenet 244, 245, 245/1, 319, 328 të Kodit Penal, 71% të totalit të procedimeve penale të regjistruara nga SPAK dhe 29% të njoftimeve/kallëzimeve, janë të bëra nga Policia, Individët, partitë politike dhe BKH. Për këtë kategori veprash penale janë regjistruar gjithsej 38 procedime, 27 prej të cilave nga vetë SPAK dhe 11 në bazë të kallëzimeve të referuara nga subjektet si Policia, Individët, partitë politike dhe BKH.

-Në hetimin e inicuar dhe të ndjekur me metoda proaktive nga ana e BKH dhe SPAK, ku në pranga kanë rënë Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë bashkë me një nëpunëse të ministrisë dhe dy drejtues të një kompanie private, nga një plan i përgjithshëm,

referuar gjetjeve dhe informacioneve të siguruara nga ekspertët e Qendrës FOL, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në platformë krijohet, një ide mbi mekanizmin dhe nivelin e përfshirjes së funksionarëve të lartë në administratën publike lokale dhe qëndrore në veprimtaritë korruptive.

Subjektet e veprës penale të korrupsionit aktiv, referuar këtij rasti por edhe rasteve të tjera nga praktika, ndjekin një linjë dhe ndërmarrin një sërë veprimesh që gjenden të përsëritura në çdo rast dhe rasti i Ministrisë së Shëndetësisë përbën një rast tipik korrupsioni në tendera. Fillimisht është synuar gjendja e pike kontakti me titullarin e institucionit ku zhvillohet tenderi publik, paraqitet një ofertë për anashkalimin e konkurrencës dhe garantimin e marrjes së kontratës publike pa garë të ndershme. Pagesa në çdo rast bëhet parapagim, dhe në rastin e kontratave të shërbimeve siç janë ato të supervizimit, rezultoi se ajo ishte përafërsisht 50% e vlerës së fondit limit, gjë që tregon nivelin e lartë të abuzimit dhe korrupsionit me fondet publike. Kjo çështje e monitoruar është mes të paktave dosje që brenda një muaji nga data e arrestimit, 2 ish zyrtarët e ministrisë së shëndetësisë dhe dy përfaqësues nga subjekte private u dërguan për gjykim për akuzën e “korrupsionit aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i K.P. dhe “korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.P.⁷

2.3. Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike.

Kjo veprë penale parashikohet në nenin 258 të Kodit Penal dhe gjatë periudhës një vjecare objekt monitorimi,

-SPAK ka nisur njëkohësisht një proces të vetëm për çështjen penale ndaj 8 funksionarëve të Bashkisë Bulqizë ku përfshihen; Kryetari dhe Nënkryetari në kohë të Bashkisë. Vërehet se nga kjo dosje, vetëm për dy shtetas gjykata vendosi masën “arrest shtëpie”. Ndërsa për 6 shtetasit e tjerë është konfirmuar masa e sigurisë “arrest me burg” nga Gjykata e Posacme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Çështja vijon të jetë në shqyrtim me kërkesën e “zbutjes së masës së sigurisë” në GJKKO, mbasi ish-kryebashkiaku me iniciale L.A. pretendon lirinë për shkaqe shëndetësore.

Një dosje tjetër e kallëzuar nga Partia Demokratike për tenderat ka të kallëzuar Kryetarin e Bashkisë Tiranë, Erjon Veliaj, por sipas kthimit të përgjigjes nga SPAK (në datë 7 korrik 2023), çështja është ende në verifikim.

2.4 Pastrimi i parave, refuzim /deklarim pasurie

Gjatë periudhës së monitorimit, (ku nuk përfshihen gjyqtarët e lartë dhe kushtetues, mbasi hetimi i tyre nuk përkon me kohën e projektit “FOL Për Drejtësinë”), sa i përket veprës së “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, parashikuar sipas nenit 257/a i K.P., GJKKO ka miratuar 17 masa sigurie prej të cilave 15 masa “arrest me burg”, 1 masë “arrest shtëpie” dhe një “detyrim paraqitjeje”.

⁷ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-17-07-2023/>

Gjykata e Apelit i zbuti masat më tej , duke vendosur 3 masa “arrest shtëpie” dhe 4 masa “detyrim paraqitjeje”. Ndërsa për 5 të tjerët , midis tyre edhe për shtetasin S.I , i cili ishte ish shofer i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, u vendos masa e sigurisë “arrest me burg “. Megjithëse, SPAK deklaroi se pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”parashikuar nga neni 287 i K.P.,të dyshuarit kontrabandonin mallra me vlerë si dhe pastronin para , deri tani, nga hetimi nuk rezulton të ketë pasuri të sekuestruara.


-Rasti i dytë i monitoruar lidhet me ish-funksionarin e lartë, ish-zv.kryeministrin me initiale A. A.⁸, i vendosur nën hetim për akuzën; e korrupsionit në 6 episode; Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, parashikuar sipas nenit 257/a i K.P.⁹ Kjo çështje u vendos nën hetim gjatë vitit 2022 dhe deri më tani ndaj funksionarit të lartë A. A., GJKKO ka në fuqi një masë sigurie “arrest në burg “, në mungesë. Në funksion të hetimit, GJKKO rezulton se nga monitorimi se ka proceduar me masë sigurimi pasuror “sekuestro preventive” mbi 6 pasuri si dhe 2 llogari bankare, po të këtij shtetasi, në shumën 124.300 euro.Vlen të theksohet se vepra e pastrimit të parave është e lidhur me vepra të tjera penale. Në një rast, rezulton se GJKKO shpalli fajtor ish kryetarin e gjykatës kushtetuese si dhe ka dorëzuar ish-gjyqtarë të tjerë për veprën penale “fshehje pasurie”. Qendra FOL ka monitoruar një rast tjetër për veprën penale “pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i K.P., për ish ministrin me initiale L.K., pasuritë e të cilit janë vendosur nën sekuestro¹⁰. Për të njëjtën akuzë në dy dosje të veçuara po zhvillohet gjykimi në mungesë nën masën “arrest me burg” në mungesë edhe për 3 biznesmenë dhe 5 shtetas që janë administratorë¹¹. Ndërkohë që SPAK ka kërkuar konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit për pasuritë për të cilat është caktuar masa e sigurisë “sekuestro preventive” nga GJKKO, të përshkruara si shoqëria tregtare “Albtech Energy”shpk, së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, në pronësi të saj, si dhe shoqëria Integrated Technology Service” sh.p.k së bashku me pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj.

⁸ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2329>

⁹ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-18-07-2023/>

¹⁰ http://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=2022-00521&ln=Lng1&uni=20230723110412185158016293792127

¹¹ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-10/>




12

2.5. Krimet Zgjedhore


Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022: Numri i materialeve kallëzuese referuese dhe informacioneve të depozituara pranë Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lidhur me krimet zgjedhore është 152, nga të cilat :

- Për 20 materiale është vendosur mosfillim procedimi;
- Në lidhje me 19 materiale dhe informacione është vendosur dërgimi për verifikim në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë;
- Për 50 materiale dhe informacione është vendosur dërgimi për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore;
- Në lidhje me 63 materiale është vendosur regjistrimi i procedimit penal.

Nga monitorimi i Qendrës FOL, rezulton se gjatë periudhës 2021-2022 janë shpallur nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë 3 vendime dënimi me 5 të dënuar me akuzën e korrupsionit zgjedhor.



Lidhur me veprën penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal për periudhën e monitoruar 01.08.2022-10.07.2023, janë regjistruar 7 raste. Këto procedime në pjesën më të madhe (5 raste) janë regjistruar nga SPAK me iniciativë të vetë organit.




Për veprën penale të “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, Prokuroria e Posacme ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” në 3 raste¹³, kërkesë kjo e cila është konfirmuar nga

¹³ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2223>

Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në 3 raste. Ndërsa Gjykata e Posacme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndryshoi masën e sigurisë vetëm për një shtetas me initiale P.K., i cili për shkaqe shëndetësore mori masën “detyrim paraqitjeje “. Rasti i kryebashkiakut Himarë me initiale Dh.F.B. u soll për kompetencë nga prokuroria e Vlorës pranë SPAK . Kandidati i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për veprën penale “korrupsion aktiv në zgjedhje “, parashikuar nga neni 328 i K.P., rezulton se është lënë në masën e sigurisë “arrest me burg “nga dy gjykatat përkatëse të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Po ashtu A. B. ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë për ndryshim masë sigurie. -Policia arrestoi shtetasin me initiale K. K. për veprën penale "Korrupsion aktiv në zgjedhje", parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Nga monitorimi i Qendrës FOL, rezulton se shtetasi K.K., në datën 14.05.2023 i ka premtuar dhe i ka ofruar personave të tjerë, shuma të ndryshme monetare me qëllim që të marrin pjesë në votime si dhe për të përcaktuar mënyrën e votimit ¹⁴. Në 1 rast, Prokuroria e Posacme ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”. Shtetasi K.A.¹⁵ u denoncua në rrjetet sociale duke diskutuar me një koordinator partie për veprën penale shitblerje votash.

Gjykata e Posaçme gjatë vlerësimit të masës së sigurisë vendosi ta zbusë atë, duke e zëvendësuar masën e sigurisë “arrest në burg” për 52-vjeçarin dhe duke e hetuar atë në "Arrest shtëpie". Në një rast , shtetasi me initiale B.M. , i dyshuar për veprën penale “korrupsion aktiv në zgjedhje”, arrestuar për shitblerje votash në Fushë-Krujë, u soll për kompetencë pranë Gjykatës së Posacme nga gjykata e juridiksionit të përgjithshëm Tiranë. Ndaj këtij, shtetasi është vendosur masa e sigurisë “detyrim paraqitjeje”.



➤ Kallëzime publike nga politika

¹⁴ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2371>

¹⁵ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2354>

Si kallëzues për veprën penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i K.P., në 2 raste është koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

-Pranë Prokurorisë së Posaçme u kallëzua kryetari i Bashkise së Kuçovës, me iniciale K. H., për akuzat e “korrupsionit në zgjedhje”, “kanosje e zgjedhësve dhe shpërdorim detyre”¹⁶. I denoncuari i dytë është një biznesmen.¹⁷

Në kallëzimin e dorëzuar në SPAK, nga deputetja Albana Vokshi, pretendohet se kallëzuesi ka rënë në dijeni të disa veprave penale të parashikuar nga nenet 248, 328 dhe 329 të Kodit Penal konkretisht, "Shpërdorimi i detyrës". "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" dhe "Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje", kryer në bashkëpunim. Në përgjigjen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme për Qendrën FOL ,këto çështje janë nën hetim.

➤ **Moskompetenca dhe mosfillime**

Gjatë kësaj periudhe monitorimi (01.08.2022-10.07.2023) vihet re, si risi trendi i rekurseve nga kallëzuesit, për vendimmarrjet e SPAK-ut për mosfillim hetimesh dhe për moskompetencën. Rezulton se gjatë kësaj periudhe janë denoncuar 51 funksionarë të niveleve më të larta , ish -president, ish-kryeministër, ish-ministër financash, ish-ministër ekonomie, ish-zv.ministër , ish-drejtor i përgjithshëm i KESH-it, për veprat penale , që nga akuza e vjedhjes së thesarit , privatizimi i Armo-s , hetimet për 21 janarit , shitja e energjisë, privatizimi i 4 Hec-eve etj. Në vetëm 2 raste në volumin e denoncimeve që prek nivelin më të lartë të ish-funksionarëve të lartë, çështjet janë bashkuar me procedime të tjera.

-U kallëzuan në SPAK, 5 zyrtarë të “Autoritetit Për Informimin”, mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, konkretisht G. S. si dhe 4 zyrtarët e tjerë : A. N. , A.H., Gj. M. dhe S. V., për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve shtetërore , falsifikim kompjuterik , falsifikim i vulave dhe formularëve, përhapje e informatave të rreme, shpërdorim detyre dhe zbulim i akteve ose të dhënave sekrete”. Kallëzimi i përcjellë në SPAK mban firmën e ish-presidentit me iniciale I.M. Nga monitorimi i kësaj çështjeje rezulton se 1 muaj nga depozitimi i këtij kallëzimi, SPAK shpalli moskompetencën dhe e delegoi çështjen për vlerësim pranë prokurorisë së Tiranës.

Prokuroria e Tiranës vendosi mosfillimin e hetimeve¹⁸ me arsyetimin se fakti nuk ekziston. Kjo çështje u kundërshtua në gjykatën e Tiranës, e cila pranoi kërkesën e kallëzuesit për të hetuar mbi 6 vepra penale. Sipas monitorimit të Qendrës FOL , vendimi u la në fuqi edhe nga gjykata e apelit, e cila shqyrtoi apelimin e prokurorisë së Tiranës, në datë 01.06.2023.

-7 familjarë të viktimave të 21 janarit kallëzuan në SPAK, ish -kryeministrin me iniciale S.B.¹⁹, ish-ministrin e brendshëm L.B., ish-komandantin e gardës N.P dhe ish-oficerin e gardës

¹⁶ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2358>

¹⁷ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2359>

¹⁸[https://www.pp.gov.al/Tirane/Media/Prokuroria Tirane vendos mosfillimin e procedimit penal ndaj Autoritetit te Dosjeve.html](https://www.pp.gov.al/Tirane/Media/Prokuroria_Tirane_vendos_mosfillimin_e_procedimit_penal_ndaj_Autoritetit_te_Dosjeve.html)

¹⁹ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2275>

A.Ll., për veprën penale “ vrasje me dashje në kuadër të grupit të strukturuar kriminal”. Në 24 shkurt 2023 , SPAK shpall moskompencën lëndore dhe e dërgon çështjen pranë prokurorisë së shkallës së parë Tiranë. Në 30 mars, GJKKO, vendosi mospranimin e ankimit të familjarëve të 4 viktimave të 21 janarit. E njëjta vendimmarje u shpall në 22 qershor edhe nga Gjykata e Apelit të Posacëm, duke e kaluar përfundimisht çështjen për kompetencë pranë prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.

-Ish-presidenti me iniciale I.M. dhe ish-kryeministri S.B. u kallëzuan në shtator 2022, për veprën penale “korrupsion i funksionarëve të lartë” dhe “pastrim i produkteve të veprës penale”. Në 30 nëntor 2022 , GJKKO vendosi shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të hetimeve, mbasi avokati kallëzues I.B. e kundërshtoi çështjen në gjykatë. SPAK iu drejtua Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me arsyetimin se vepra penale e pastrimit të parave, nuk ka asnjë indicie që lidh dy ish-funksionarët me 5 zyrtarët e dënuar, në kohën kur ndodhi vjedhja e thesarit (A.H. P.D, E.H., A.B, B.H). Ndërsa Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e mosfillimit të SPAK-ut. Aktualisht çështja është në Gjykatën e Lartë.

-Rasti tjetër i referohet 2 personave me detyrën e punonjësit të Policisë. Prokuroria pranë gjykatatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë ka regjistruar procedimin ndaj 2 personave me akuzën e kryerjes së veprës penale të “*Korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, të parashikuar në nenin 259 të Kodit Penal.

Hetimet për këtë rast, në fillim u kryen nga Prokuroria e Tiranës, por dosja i kaloi Prokurorisë së Posacme, me vendim të Gjykatës së Tiranës, ditën e masës së sigurisë. Inspektori A. Ç²⁰, me detyrë në Patrullën e Përgjithshme, në Sektorin e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, u arrestua nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore pas një hetimi disa mujor me dyshimet se është përfshirë në korrupsion gjatë ushtrimit të detyrës së tij, si punonjës policie. Bashkë me të, u arrestua edhe inspektori tjetër i “Shqiponjave”, shtetasi H. Xh.²¹. Arrestimi u krye pasi këta punonjës policie u kapën në flagrancë duke i marrë një drejtuesi mjeti 100 euro, me qëllim shmangien e ndëshkimit të tij me masë gjobe për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor.

-Rast tjetër është kallëzimi i bërë nga shtetasi G. P²². i cili ka kallëzuar në SPAK të gjithë veprimtarinë e administratorëve të serverave në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe 4 drejtues për sulmin kibernetik, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës “, në bashkëpunim. SPAK ia dërgoi për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kalimi i kompetencës në Prokurorinë e Tiranës u krye tre ditë, pas dorëzimit të kallëzimit.

-Një gjyqtar B.H²³., rezulton i kallëzuar publikisht nga gazetari F.C. për akuzën “shpërdorim detyre“, “korrupsion aktiv i gjyqtarit”. Sipas kallëzuesit , gjyqtari kishte dhënë një vendim

²⁰ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2407>


²¹ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2408>

²² <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2264>

²³ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2265>

pafajësie për një gazetar tjetër, i paditur për shpifje. Nga të dhënat e databazës “FOL”, rezulton se 2 javë më pas, çështja u mosfillua nga SPAK.

Rezulton se gjithsej janë 25 zyrtarë dhe dy institucione (AKSHI dhe Prokuroria e Tiranës) të kallëzuar publikisht ,për të cilat çështjet janë mosfilluar. Vetëm një prej tyre, që i përket denoncimit të gazetarit A.D. është bashkuar me një procedim të mëparshëm, ndaj ish-funksionarit të lartë A.H.



KREU III

LUFTA KUNDËR DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

3.1. Lufta kundër trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar

Indeksi Global i Krimit të organizuar, është një mjet botëror që vlerëson nivelet e krimit të organizuar dhe qëndrueshmërinë ndaj veprimtarisë kriminale të organizuar. Ai përfshin në rendin e tij të gjitha shtetet anëtare .

Përsa i përket Shqipërisë, ky indeks tregon se vendi ynë - "*Dominohet nga rrjete kriminale të mbivendosura dhe aktorë të stilit mafioz familjar. Grupet e stilit mafioz kontrollojnë tregjet kriminale për drogën, trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën e njerëzve dhe thuhet se po kalojnë në prokurimin publik. Ata e kanë pozicionuar veten si disa nga organizatat kriminale më të fuqishme në Evropë. Grupet e stilit mafioz shqiptar ndryshojnë nga mafia të tjera të mëdha (si ajo italiane), në atë që ata rrallë e identifikojnë veten me emra ose simbole.*"


Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit në raportin e fundit të drogave (për vitin 2022) raporton se Shqipëria është një nga vendet kryesore tranzit të trafikimit të heroinës dhe kokainës të identifikuar nga UNODC.

Raporti i referuar nga kjo zyrë, publikoi dy harta në të cilat përfshihet Shqipëria. Në hartën e parë: “Vendet kryesore të identifikuar si burim dhe tranzit i ngarkesave të heroinës, bazuar në konfiskimet për periudhën 2018-2021”, Shqipëria është e identifikuar së bashku me shtete të tjera të Ballkanit, si rrugë tranzite e trafikimit të heroinës. Në një tjetër hartë “Rrugët e raportuara të trafikut të kokainës dhe kanabisit midis shtetit shumëkombëtar të Bolivisë dhe vendeve dhe territoreve të tjera, 2010–2022”, Shqipëria ka lidhje direkte me Bolivinë për trafikun e kokainës.

Ekspertët e Qendrës “FOL” kanë monitoruar një numër të lartë të materialeve të depozituara pranë organeve proceduese në fushën e drogërave. Më konkretisht 57 raste ose rreth 29.2% e numrit total të materialeve, janë monitoruar në këtë kategori.


Për vitin 2022 janë dërguar për gjykim 10 çështje penale, me 25 të pandehur për vepra penale në kuadrin e krimit të organizuar. Në 9 çështje është proceduar për kryerjen e veprës penale të “Grupit të Strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a i K.P së bashku më atë të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/a i K.P.

1 çështje është proceduar me akuzën e kryerjes së veprës penale të “Kryerjes së veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334 i K.P.



Sa i përket volumit të materialeve të regjistruara rezulton se vepra penale e ‘trafikimit të lëndëve narkotike’ në formën e saj klasike, parashikuar nga neni 283/a i K.P., është dispozita në referim të së cilës janë depozituar numri më i lartë i materialeve. Më konkretisht 30 raste ose rreth 53% përkojnë me këtë dispozitë, ndjekur nga neni 283/1 i K.P., me 13 raste ose rreth 23% dhe nga neni 284 K.P, me 13 raste ose rreth 23%.

Tabela më poshtë, tregon se si ka ndryshuar numri i rasteve të regjistruara nga Prokuroria e Posacme për veprat penale të kategorizuara tek ‘Droga’ dhe ‘Krimi i Organizuar’ nga 1 Janar 2023 deri në 01 Korrik 2023. Muaji janar dhe qershor kanë patur një numër të lartë procedimesh të regjistruara.




3.2. Trafikimi i lëndëve narkotike sipas nenit 283/a Kodit Penal.

Për këtë vepër penale janë regjistruar nga Prokuroria e Posacme 30 raste. Në të gjitha rastet organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, për 29 raste, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në 29 raste.

Vetëm në 1 rast prokuroria ka kërkuar masën “arrest në shtëpi”,²⁴ kërkesë e cila është pranuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

²⁴ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2405>



Sic mund të konstatohet dhe nga grafiku, raporti i masave të sigurimit të kërkuara nga Prokuroria me masat e sigurimit të dhëna nga Gjykata është në përpjestim të drejtë.

-Policia arrestoi shtetasin me initiale M.R²⁵ me dyshimet e trafikut të lëndëve narkotike dhe grupit të strukturuar kriminal. Arrestimi i tij u krye pas hetimit të SPAK dhe bashkë me të u arrestuan edhe 9 persona të tjerë, për organizimin e trafikut të 430 kilogramëve kokainë nga Kolumbia në Shqipëri.

Lënda narkotike ishte fshehur në mes të 26 ton pleh kimik që u porosit nga një kompani private, e cila u themelua nga një prej të arrestuarve në janar të këtij viti. Ngarkesa u nis nga Kolumbia në maj të 2022 dhe mbërriti mes portit të Pireut në Greqi dhe Malit të Zi në muajin shtator në Shqipëri.


3.3 Kultivimi i bimëve narkotike sipas nenit 284 i Kodit Penal.

Për këtë vepër penale janë depozituar 14 materiale, ndaj 11 prej tyre është kërkuar caktimi i masës “arrest në burg”, kërkesë e cila është aprovuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në 11 raste. Në një rast, SPAK ka kërkuar masën “detyrim paraqitjeje”, që është aprovuar nga Gjykata e Posacme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e organizuar . Në dy raste, është kërkuar nga SPAK dhe vendosur nga gjykata masa e sigurisë “arrest shtëpie”. Për këtë vepër penale , janë në kërkim 4 persona . Gjykata e Posaçme zbuti masën e sigurisë për shtetasin S.V²⁶, duke e lënë atë në masën e sigurimit "Arrest shtëpie", për shkak të moshës së tij (73 vjeçar). Për këtë çështje nuk ka nisur ende hetimi pasuror. Për sa i takon kultivimit të drogës , SPAK ka vendosur sekuestro të pasurive ndaj 2 shtetasve të dyshuar të hetuar në Belgjikë , për veprën penale “kultivim të bimëve narkotike” për 5 pasuri , 4 apartamente , 1 mjet motorik ²⁷.

²⁵ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2255>

²⁶ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2336>

²⁷ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-06-04-2023/>



3.4 Vepra penale “Grupi i Strukturuar Kriminal”, parashikuar në nenin 333/a të Kodit Penal


Për periudhën 01.07.2022-10.07.2023, SPAK ka regjistruar 85 raste për veprën penale të “Grupit të Strukturuar Kriminal”, të parashikuar në nenin 333/a të Kodit Penal. Është konstatuar se 30 % e tyre është dhënë masa e sigurisë në mungesë dhe janë aprovuar nga të gjitha shkallët e gjykatave. Prej këtyre të proceduarve që kanë kryer krime në kuadër të grupit të strukturuar penale, rezultojnë se 41 shtetas janë proceduar për veprën penale “trafikim i lëndëve narkotike”. 17 shtetas të tjerë dyshohet se kanë kryer “kontrabandë në kuadër të grupit të strukturuar kriminal”. 7 shtetas janë për veprën penale “për sigurim i kushteve dhe materialeve për të kryer vrasje”. Vihet re se, autoritetet shqiptare në bashkëpunim me skuadrat e përbashkëta hetimore ndërkombëtare (Itali, Greqi, Francë, Suedi, Belgjikë,) kanë kryer hetime për goditjen e grupeve kriminale në fushën e drogës ²⁸, por edhe në veprën penale të “vrasjes me paramendim në kuadër të grupit” ²⁹, si dhe “kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”³⁰. Po ashtu, nga monitorimi i Qendrës FOL konstatohet se, kryerja e veprimeve “mashttrim kompjuterik në bashkëpunim” në formën e grupit të strukturuar kriminal, për të cilat në 2 raste është vendosur masa e sigurimit “arrest me burg”, për llogari të gjykatës së Pisës në Itali. Në 20 raste të regjistruara nga Prokuroria e Posacme gjatë periudhës së monitorimit për veprën penale të “Grupit të Strukturuar Kriminal” të parashikuar në nenin 333/a të Kodit Penal, nga të cilët 11 shtetas janë në kërkim. Cështja është hetuar me partnerët ndërkombëtare dhe është

²⁸ <https://spak.gov.al/spak-ne-bashkepunim-me-autoritetet-italiane-greke-godasin-4-grupe-kriminale-te-kontrabandimit-te-njerezve/>

²⁹ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-27-06-2023/>

³⁰ <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-15/>

dërguar për gjykim.³¹ Vetëm në një rast, gjykata me kërkesë të SPAK ka vendosur masën e sigurisë “arrest shtëpie”, ndërsa për 8 të arrestuarit është dhënë masa e sigurisë “arrest me burg”. Nga monitorimi i ekspertëve të Qendrës FOL, mungojnë hetimet pasurore për këtë kategori veprash , ndonëse në deklaratat zyrtare citohet “*aktiviteti call center në kuadër të grupit duke shkaktuar miliona euro dëm qytetarëve europiane*”. Në grupin tjetër, megjithëse dëmi llogaritet 50 milion euro, çdo 3 muaj janë sekuestruar vetëm pajisje kompjuterike dhe portofole kriptovalutash.³²



3.5. Vepra penale e “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal

Prokuroria e Posacme lidhur me këtë vepër penale (së bashku me vepra te tjera penale) ka regjistruar 58 procedime.

Prokuroria e Posacme ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për 53 raste, kërkesë e konfirmuar nga Gjykata e Posacme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në 49 raste ose rreth 92% të rasteve. Në 1 rast, Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për shkak se personi nën hetim ishte student³³.

Në 4 raste, Gjykata e Apelit ka vendosur mospranim ankimi sepse ankimi ishte dorëzuar jashtë afateve të përcaktuara në ligj.³⁴

³¹ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2240>

³² <https://spak.gov.al/komunikate-per-shtyp-2/>


³³ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2382>

³⁴ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2269>

Në 2 raste personat nën hetim nuk e kanë ankimuar vendimin e masës së sigurimit dhënë nga Gjykata e Posacme e Shkallës së Parë.³⁵

Në 1 rast ankimesi hoqi dorë nga ankimi në Gjykatën e Posacme të Apelit³⁶. Ndërsa rastet e tjera për veprën penale “kryerja e veprave penale nga organizatat kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal” u la në fuqi masa e sigurisë, të Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në 4 raste, personat nën hetim kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Në 2 raste, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e Vendimit të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe kthimin e çështjes për rigjykim.



Disa nga rastet e monitoruara që janë kthyer për rigjykim:

-Gjykata e Posaçme la në fuqi masën e sigurisë "Arrest në burg" për shtetasin me initiale B. H.³⁷ Ai e ankimoi vendimin e Shkallës së Parë, por për shkak se ankimi ishte dorëzuar jashtë afateve, Gjykata e Posacme e Apelit vendosi mospranimin e tij. B. H. dorëzoi rekurs në Gjykatën e Lartë dhe kjo e fundit në datën 15 qershor 2023, ktheu çështjen për rigjykim duke e prishur vendimin e Gjykatës së Posacme të Apelit.

-Gjykata e Posaçme la në burg shtetasin M. D.³⁸. Ai ankimoi më pas vendimin, por për shkak të dorëzimit jashtë afatit, Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vendosi mospranimin e ankimit pasi ishte dërguar jashtë afateve të përcaktuara.

³⁵ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2268>

³⁶ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2267>

³⁷ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2266>

³⁸ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2269>

M. D. dorëzoi rekurs në Gjykatën e Lartë në lidhje me masën e sigurisë dhe kjo e fundit vendosi prishjen e vendimit të Apelit, duke kthyer çështjen për rigjykim.

KREU IV

4.1 Monitorimi i veprave penale nga projekti i parë “FOL Për Drejtësinë”

Ekspertët e Qendrës FOL kanë monitoruar gjithashtu edhe ecurinë e veprave penale në fushën e drogës dhe shpërdorimit të detyrës.

Nga 01.11.2020-31.10.2021, ekspertët e Qendrës “FOL” monitoruan procesin e procedimeve penale pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe disa nga veprat penale në Strukturën e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, (Spak).

Gjithashtu ekspertët kanë hulumtuar praktikën hetimore dhe gjyqësore deri tek gjykimi në Gjykatën e Lartë të çështjeve të monitoruara gjatë projektit të parë “FOL për Drejtësinë” përmes databazës <https://webapp.fol.org.al/publik.php>.

Veprimtaria e ekspertëve u bazua në një metodologji të specifikuar monitorimi që u reflektua në ngritjen e një databaze, bazuar në domosdoshmërinë e reflektimit të të dhënave mbi kategorinë e figurave të veprave penale që janë pjesë e Kreut VIII “Krime kundër autoritetit të shtetit”, Seksioni III “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, të cilat janë reflektuar nga ana e ligjvënësit në dispozita materiale penale, nenet 283, 283/a, 283/b, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 285/a, 285/b dhe 286 të Kodit Penal; si dhe figurat e veprave penale që kanë si qëllim goditjen e fenomenit të korrupsionit të kryer nga funksionarë publikë, të cilat kanë një impakt të drejtpërdrejtë në cënimin e interesit publik dhe integritetit institucional e shtetëror pjesë e kërreëve III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, VIII “Krime kundër autoritetit të shtetit” dhe IX “Vepra penale kundër drejtësisë”, pjesë e seksioneve I,4 II.5 dhe III.6 të Kodit Penal. Më konkretisht, në kategorinë e dytë objekt monitorimi përfshihen nenet 135, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 313, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e K.Penal.

Gjatë monitorimit nga ana e ekspertëve u vërejt me interes shtrirja e fushëveprimit edhe në veprat penale të realizuara nga ana e eksponentëve të caktuar kriminalë, bazuar në nenin 333/a “Grup i strukturuar kriminal” të cilët u proceduan penalisht për kryerjen e veprave penale në rrethana cilësuese.

Në përfundim të projektit të parë “FOL për Drejtësinë”, Qendra FOL publikoi një raport mbi ecurinë e procedimeve në të treja institucionet; polici-prokurori-gjykatë.³⁹

Ekspertët e Qendrës “FOL” gjatë periudhës 01.08.2022-10.07.2023 monitoruan vijueshmërinë dhe qasjen e institucioneve të drejtësisë për çështjet që ishin referuar për hetim (gjatë projektit të parë).

Nga ana e Prokurorisë së Tiranës, është kthyer përgjigje në datë 06.07.2023 duke cituar *“pamundësinë objektive për të realizuar verifikimin e rasteve për shkak të ngarkesës si edhe numrin të madh të emrave”*

³⁹ <https://fol.org.al/wp-content/uploads/2021/10/Raport-Final-Monitrimi.pdf>

Në kategorinë e drogës, Qendra monitoroi vijueshmërinë e 93 rasteve me masë sigurimi “arrest me burg “. Monitorimi u krye në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë ,Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Lartë. Është konstatuar se në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, u dorëzuan të pandehur për veprën penale “prodhim dhe shitje narkotikësh”parashikuar nga nenet 283/1 dhe 283/2, dhe më pas u shpallën fajtorë 57 shtetas . Gjithashtu ka rezultuar se nga monitorimi i ekspertëve , 1 rast u pushua⁴⁰, sepse i dyshuari ndërroi jetë. Për 10 shtetas të tjerë u dorëzuan të pandehur për akuzën tjetër nga ajo që ishte referuar procedimi nga policia e Tiranës, (shtetasit e mësipërm u referuan nga policia për veprën penale “prodhim dhe shitje narkotikësh”). Nga monitorimi në gjykatë, rezulton se kjo akuzë u mosfillua mbasi nga rezultatet e Institutit të Mjekësisë Ligjore(IML) rezultuan përdorues të lëndëve narkotike. Megjithatë, ata u dorëzuan për një vepër tjetër penale “drejtim mjeti në gjendje të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Ndërsa një rast tjetër, gjykata vendosi pafajësinë e një shtetasi.⁴¹

Përsa i takon veprës penale “kultivimit të bimëve narkotike”,parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal , rezulton se Gjykata e Tiranës ka shpallur fajtor 16 persona ⁴² . Për 1 shtetas me detyrë kryeplak , Gjykata e Tiranës e shpalli fajtor për veprën penale “shpërdorim detyre dhe kultivim i bimëve narkotike”. Në 4 raste, është vendosur pushimi i gjykimit për veprën penale “shpërdorim detyre“, parashikuar nga neni 248 i K.P. , ndërsa për veprën penale “përshtatja e lokalit për përdorim droge “, parashikuar nga neni 285 i K.P., u shpallën fajtorë 2 persona. Në gjykatën e Apelit , njëri prej tyre u shpall i pafajshëm dhe 1 tjetër u shpall fajtor.

Në Gjykatën e Apelit, përsa i përket “veprës së prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283 i K.P., (për rastet e monitoruara nga projekti i parë) janë dënuar 35 shtetas⁴³, për 7 persona është pushuar akuza dhe 13 shtetas janë ende në proces gjykimi. Për 5 shtetas që ishin referuar për akuzën e “prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” (parashikuar nga neni 283 i K.P) nga ana e policisë , ata përfunduan të pandehur në gjykim për veprën penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i K.P. dhe gjykata e apelit dha vendimin për ta, për veprën e “moskallëzimit të krimi” (ndryshe nga çfarë vepre ishte referuar nga policia).

- Në një rast, I shtetas i arrestuar për veprën penale “prodhim dhe shitje narkotikësh” rezulton se u ndryshua masa e sigurisë nga “arrest me burg” , në “arrest në shtëpi” dhe gjatë kësaj kohe ai konstatohet nga policia se kishte thyer masën e gjykatës. Në përfundim të hetimeve , mjekësia ligjore ktheu përgjigjen për të dyshuarin dhe konfirmoi që ishte përdorues droge. Në këto kushte , prokuroria pushoi hetimin për veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, por e dorëzoi atë të pandehur për veprën penale “largim nga vendi i vuajtjes së dënimit.”



⁴⁰ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=89>

⁴¹ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=152>

⁴² <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=1057>

⁴³ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=151>

VENDIMET E GJYKATES SE TIRANES PER VEPREN PENALE "SHPERNDARJE DROGE"



Ndërsa për veprën penale “korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal janë dënuar 23 shtetas , të cilët u denoncuan në kushtet e flagrancës nga oficerët e policisë, gjatë tentativës për t’u dhënë rryshfet.

U konstatua që qytetarët për këtë vepër penale janë gjykuar në masën “detyrim paraqitjeje” dhe kanë mbajtur qëndrim mohues për veprimin e tyre (dhënien e ryshfetit punonjësve të policisë).⁴⁴


- Në 1 rast, Gjykata e Tiranës ka shpallur arrestim e paligjshëm të të dyshuarit, e arrestuar për veprën penale “korrupsion aktiv që ushtronë funksione publike“. Në materialin referues, policia referon se qytetari në afërsi të “Stacionit të Trenit” i ofroi një pije freskuese efektivit të policisë rrugore dhe kjo u konsiderua si veprim korruptiv , mbasi së bashku me të (pijen freskuese), ai ofroi edhe listën e dokumentacionit, ku sipas efektivëve të policisë, qytetari kishte vendosur një sasi vlerë monetare. Gjykata e Tiranës, shpalli të pafajshëm qytetarin. Ndërsa në Gjykatën e Apelit, çështja është në proces gjykimi.

Lidhur me veprën penale “shpërdorim të detyrës“ , të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, rezulton një shtetas i shpallur fajtor ⁴⁵. Në rastin e dytë të dorëzuar në gjykatë për veprën penale “shpërdorim detyre“, hetimet e nisura ndaj një zyrtari të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit(IMT) me iniciale M.Q, dhe ndaj 3 punonjësve të tjerë të këtij institucioni , prokuroria ka kërkuar zgjatjen e afateve hetimore dhe dosja aktualisht gjendet e papërfunduar në Gjykatën e Apelit.

-Në një rast , procedimi i nisur ndaj 24 shtetasve , punonjës në Aeroportin e Rinasit, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.P., nuk u finalizua në Gjykatën e Tiranës me të pandehur për këtë vepër. Masat e sigurisë ndaj 3 prej kontrollorëve për akuzën “e shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim”, u zhbënë më tej në Gjykatën e Apelit. Rezulton se Prokuroria e Tiranës edhe për këta të dyshuar e mosfilloi

⁴⁴ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=177>

⁴⁵ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=799>



hetimin për veprën penale “ shpërdorim detyre”, ndërkohë që vijoi hetimet për një akuzë tjetër që lidhet me pengimin për të fluturuar , por që edhe ajo në përfundim u pushua.

➤ Gjykata e Posacme e Shkallës së Parë/ e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Nga çështjet nën monitorim dhe që ishin nën hetim gjatë projektit të parë “FOL për Drejtësinë” janë shpallur fajtorë nga Gjykata e Shkallës e Posacme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 77 shtetas, për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259, “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244, “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248, “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, parashikuar nga neni 258, “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/c, “Trafikimi i narkotikëve” ,parashikuar nga neni 283/a , “Kultivimi i bimëve narkotike” , parashikuar nga neni 284, “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 , “Grupi i strukturuar kriminal “, parashikuar nga neni 333/a .


-Midis tyre ish-gjyqtaren e Krujës me initiale E. H⁴⁶për akuzën e “Korrupsionit pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar sipas nenit 319/ç, si dhe ish-kryesekretaren e gjykatës me initiale M.M, ish-avokatin A.T, dhe 4 shtetas të tjerë të akuzuar për veprën penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, sipas nenit 319 të Kodit Penal. GJKKO e shpalli fajtores ish-gjyqtaren e Krujës dhe personat e tjerë në dosje. Dënimet u lanë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

⁴⁶ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=450>

-Po ashtu rezulton se nga monitorimi, ish-kryetari i bashkisë së Lushnjës u arrestua për akuzën e “shpërdorimit të detyrës”, sipas nenit 248 të K.P. U shpall fajtor nga Gjykata e Posacme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar , për të njëjtën veprë penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K.P. dhe i pafajshëm për akuzën e “shkeljes në barazisë në tendera apo ankande publike” , parashikuar nga neni 258 i K.P.⁴⁷. Gjykata e Posacme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e prishi vendimin e mësipërm dhe e shpalli fajtor edhe për veprën penale “Shkelje e barazisë në tendera”, parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal. Rezulton se volum të lartë të personave të vënë në hetim e përfshin vepra penale “Shkelja e barazisë në tendera“, parashikuar nga neni 258 i K.P , shpallur fajtor nga Gjykata e Posacme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 25 shtetas.

-Për veprën penale të tenderave të uniformave të policisë, u dënuan ish-drejtoresha e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara, me initiale E.N.⁴⁸ dhe 9 ish-zyrtarë të tjerë. Nga monitorimi rezulton se për 3 ish-zyrtarë, Gjykata e Posacme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar , ndryshoi vendimin për 3 ish-zyrtarë , duke urdhëruar dhënien në provë për pjesën e pa vuajtur të dënimit.


-20 shtetas të tjerë janë dorëzuar nga SPAK në Gjykatën e Posacme si të pandehur për akuzën e “Ushttrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”,⁴⁹ parashikuar nga neni 245/1 i K.P.



⁴⁷ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=1396>

⁴⁸ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=1411>

⁴⁹ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=2298>
<https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-21-07-2023/>



Nga rastet e monitoruara që ishin pjesë e projektit të parë “FOL për Drejtësinë”, Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka dhënë 29 vendime fajësie.

-Po ashtu, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin për një rast me të akuzuar ish-kryeprokurorin e Kukësit, me initiale E.K.⁵⁰ i dënuar nga shkalla e parë me shërbim prove, për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal . Apeli e dënoi shtetasin me initiale E.K. me 3.6 vjet burg, që në ulje të 1/3 të dënimit u llogarit 2.4 vjet burgim. Ky vendim e ktheu në burg ish-kryeprokurorin, i cili u arrestua për një shumë monetare prej 2000 euro.

KREU V

5.1 Problematika të hasura gjatë punës hulumtuese 12-të mujore

1.Gjatë fazës së monitorimit për hartimin e këtij raporti monitorimi 12 mujor konstatohen të njëjtat problematika që janë hasur edhe më parë se; baza burimore e informacioneve të raportuara dhe të analizuara në të shumtin e rasteve vjen nga komunikatat e Policisë së Shtetit/SPAK dhe njoftimet që kallëzuesit i bëjnë publike. Sa i takon procedimeve dhe gjykimeve pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm, prokuroria nuk bën transparencë me palët e arrestuara, të vendosur nën hetim dhe që më pas lirohen apo çështjet mosfillohen/pushohen.

⁵⁰ <https://webapp.fol.org.al/ppublik.php?id=1391>

Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm bën prezente raste sporadike dhe jo rregullisht për çështjet që dorëzon në gjykatë. Kjo qasje sjell një panoramë të paqartë mbi dosjet ende të pahetuara për kategorinë e drogës dhe të shpërdorimit të detyrës. Ndryshe nga SPAK, Prokuroria e Tiranës ka një nënfaqe në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme <https://www.pp.gov.al/Tirane/>, pavarësisht se kjo prokurori duhet të ketë të aktivizuar prokurorin e medias .

2.Referuar edhe websitit të Spak <https://spak.al/category/media/> komunikimet janë sporadike dhe jo periodike. Në garantim të të drejtës për informim por edhe të mbrojtjes së të dhënave personale, aktet finale të procedimeve gjyqësore, në rastet kur nuk dëmtohen hetimet dhe nuk çenohet sekretet hetimor, SPAK duhet të garantonte përcjelljen e tyre në publik.

Kjo përbën një problematikë të zgjidhshme nga ana e SPAK, për aq sa në zbatim të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar, redaktimi i vendimeve gjyqësore, duke fshehur të dhënat sensitive dhe personale do të garantonte transparencë publike dhe mediatike , si dhe do të ndikonte jo vetëm në rritjen e besueshmërisë së publikut në institucione, por gjithashtu do të jepte një panoramë të qartë të ecurisë së hetimeve, vecanarisht mbi çështjet “korrupsion në zgjedhje “, “shpërdorim detyre” etj, për të cilat vendoset moskompetenca/mosfillim.

3.Ndërsa faqja zyrtare e Gjykatës së Tiranës, lejon akses por vecse në mënyrë të kufizuar, vetëm nëpërmjet numrit të çështjes penale dhe pasjes së një kodi anonimati. Pavarësisht faktit që në cdo rast synohet nga ana e organeve gjyqësore ruajtja e anonimatit, duhet të marrë në konsideratë që vendimet shpallen dhe janë publike, gjë që nënkupton pa asnjë ekuivok që vendimet duhet të jenë të aksesueshme, qoftë edhe me iniciale, duke fshehur të dhënat personale.

4.Ndërsa vijon të mbetet problematikë publikimi i vendimeve përfundimtare në të gjitha gjykatat (me përjashtim të Gjykatës së Lartë).

Në komunikimin e Qendrës FOL “nëpërmjet kërkesës për informacion me ILD (Inspektorati i Lartë i Drejtësisë) për mospublikimin e vendimeve në faqen e gjykatave, ILD citon se “*për vitin 2022-2023 nuk është kryer ende një inspektim me këtë fokus*”.

5.2 Rekomandime

1.Nisur nga qasja e gjykatave për veprën e shpërndarjes së drogës dhe numrin e lartë të hetimeve që nuk kanë marrë zgjidhje, rekomandohet inspektim i Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML), mbi arsyet se përse vonohen analizat toksikologjike dhe dhënien e një zgjidhjeje .

2.Për shkak të vetingut , shumë çështje nën monitorim (projekti i parë “FOL për Drejtësinë”për periudhën 01.11.2020-31.10.2021) , janë rishortuar dhe janë ende në pritje . Kjo situatë konstatohet edhe në Prokurorinë e Tiranës, edhe në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, duke sjellë zvarritje të procedimit dhe të gjykimit. Për sa më lart, institucionet e reja të drejtësisë të marrin masa , që çështjet e mbartura tu jepet zgjidhje sa më herët.

3.Të vijohet me forcimin e luftës kundër korrupsionit nëpërmjet ndjekjes penale, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin dhe të zbatohen standardet më të mira në drejtim të garantimit të të drejtave të njeriut në procedimet

penale, të drejtës për proces të rregullt, parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit dhe parimit të proporcionalitetit, parimit të ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

4. T'i kushtohet një vëmendje e shtuar kallëzimeve të paraqitura nga qytetarë, partitë politike, media, subjekte të ndryshme, në garantim të respektimit të një afati të arsyeshëm, në hetim dhe gjykim. Kjo do të rriste ndjeshëm besimin e publikut.

5. Institucionet e reja të drejtësisë (Gjykatat dhe prokuroritë) duhet të marrin masa që vendimet përfundimtare ti publikojnë në faqen e tyre web. Kjo do të ndikonte për të analizuar në kohën e duhur fenomenin e shoqërisë që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

6. Rëndësi të vecantë duhet të marrë edhe realizimi, zbatimi i marrëveshjeve teknike të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen me korrupsionin, pastrimin e parave, krimin e organizuar, si dhe luftën kundër terrorizmit.